

**“ 2L ALD-DRIN” SHPK
POGRADEC**

AKT THEMELIMI

Sipas kërkesave të Ligjit 9901 ,datë 14.4.2008, ”Për tregetaret dhe shoqëritë tregetare”

POGRADEC, 2022

AKT THEMELIMI I SHOQERISE
“2L ALD-DRIN” SHPK
POGRADEC

Ne Pogradec sot me date 12 **Korrik** 2022,ne respektim te kerkesave te ligjit nr.9901,date 14.4.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare”,me cilesine e ortakut te vetem;Dritan KILLO , i biri i Pëllumpit, lindur me 01.09.1977 ne Pogradec dhe banues ne Pogradec,shtetas shqiptar,mbajtes i **leter njoftimit/card no.nr.034438765** Me vullnet te plote e te lire,bazuar ne vendimin e dates 12 Korrik 2022 te ortakut te vetem te shoqerise,ne ligjin 9901 ,date 14.4.2008,”Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”,Ligjin nr. 9723,date 3.5.2007 “ Per Qendren Kombetare te Biznesit”, hartohet ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“2L ALD-DRIN” sh.p.k** (me poshte e quajtur Shoqeria).

KRIJIMI

Shoqeria **“2L ALD-DRIN” sh.p.k.** eshte person juridik i te drejtes shqiptare,Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur shoqeria)..

SELIA

Shoqeria e ka seline ne Pogradec, Lagjia 1, Rruga e Volorekes, Nr.ap.:3, numri i pasurise 6/581+1-3. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj,te hape zyra perfaqsie,dege,te krijojte filiale si brenda edhe jashte Pogradecit,vetem me vendim te ortakut te vetem.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitet privat me kete objekt veprimtarie:

NP-1 A.Punime gërmimi në tokë

NP-2 A.Ndertime civile dhe industriale

NP-3 A.Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash, civile e industriale, veshje fasadash

NP-4 A.Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha,tramvai, metro, pista aeroportuale

NP-7 A.Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi dhe vaditje

NS-1 A.Punime për prishjen e ndërtimeve

NS-2 A.Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre

NS-4 A.Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

NS-6 A.Sinjalistika rrugore jo ndricuese

NS-7.A.Barriera dhe mbrojtje rrugore.

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pa kufizuar.

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije leke).Kapitali i mesiperm eshte neneshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortakja e vetme e shoqerise :DritanKILLO,***zoteruese e 1(nje) pjese , e cila perfaqson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.***

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te palujtshme e te lujtshme apo te drejta).Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund të zmadhohet nepermjet neneshkrimeve të pjeseve të kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane të kontributeve ne natyre,ne sherbime,nepermjet emerimit të nje eksperti të autorizuar per keto kontribute ne netyre sipas kerkeses se administratorit.

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund të zvogelohet me vendim të ortakut të vetëm ne të njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Vendimi per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare të Regjistrimit per regjistrim nga administratori,ne perputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723,datë 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare të Regjistrimit”.

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të nje shoqerie me pergjegjesi të kufizuar e të drejtat qe rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet;

- a)kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b)shitblerjes;
- c)trashegimnise;
- c)dhurimit;
- d)cdo menyre tjetër e parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit të kuotave me kontratë,kjo e fundit duhet të behet me shkrim.

Personi qe kalon kuotën dhe ai qe e fiton atë,pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotës,nga casti i kalimit të kuotave,deri ne castin e regjistrimit të kalimit të tij ne Qendren Kombetare të Regjistrimit,sipas nenit 43 të ligjit nr.9723,datë 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare të Regjistrimit”.Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht të transferueshme me rruge trashegimnie.

ADMINISTRIMI

Administrator i shoqerise eshte Zoti Dritan KILLO , lindur me 01.09.1977 ne Pogradec dhe banues po ne Pogradec,shtetas shqipetar,mbajtes i leter njoftimit me nr. 034438765 .**Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 (pese)vjecar ,me te drejte riperteritje** nga momenti i miratimit te Statutit.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise.

Administratori i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte shoqerise.

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky akt themelimi u redaktua nga une ortak i vetem ne 2 (dy) ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

ORTAKU I VETEM

Dritan KILLO